

LIGJ

Nr. 9445, datë 16.11.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8869, DATË 22.5.2003 "PËR
GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e
Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8869, datë 22.5.2003 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë",
bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 4

Garda e Republikës së Shqipërisë ruan dhe mbron:

- a) Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, si dhe familjet e tyre;
- b) personalitetet e huaja, të të njëjtit nivel me personalitetet shqiptare të përmendura në shkronjën "a", që vijnë në vendin tonë, si dhe personalitete të tjera të huaja, për të cilët Ministri i Brendshëm e vlerëson të nevojshme ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre;
- c) personalitetet shtetërore vendase, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
- ç) rezidencat presidenciale, selinë dhe zyrat e Kuvendit të Shqipërisë, selinë e Këshillit të Ministrave dhe mjediset ku vendosen personalitetet e huaja, të përcaktuara në shkronjën "b" të këtij neni;
- d) banesat e personaliteteve të larta shtetërore dhe seli të tjera shtetërore, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 2

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 5

1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri ruhen dhe mbrohen edhe 3 vjet pas lirimit të tyre nga funksioni.
2. Personalitetet e tjera shtetërore vendase, të cilat ruhen dhe mbrohen pas lirimit nga funksioni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, por, në çdo rast, jo më shumë se 3 vjet pas lirimit nga funksioni."

Neni 3

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 6

Garda e Republikës siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e objekteve gjatë veprimtarive, ku marrin pjesë Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe personalitetet e përcaktuara në shkronjat "b" e "c" të nenit 4 të këtij ligji."

Neni 4

Të gjitha emërtimet "Ministria e Rendit Publik" zëvendësohen me emërtimet "Ministria e Brendshme".

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 4710, datë 5.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu